



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 14796 Prot

Shkodër, më 21 / 07 /2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt vendimi për: Miratimin e kërkesës për transferimin të 89.65% aksioneve të "Duhan Cigare" sh.a nga Ministria e Ekonomisë Kultures dhe Inovacionit në pronësi të Bashkisë Shkodër.

KËSHILLIT BASHKIAK SHRODËR

Të nderuar këshilltarë, Referuar ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" të ndryshuar, VKB nr. 60, date 28,12,2020, "Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të Keshillit bashkiak Shkoder", bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt vendimin për miratim: "Miratimin e kërkesës për transferimin të 89.65% aksioneve të "Duhan Cigare" sh.a nga Ministria e Ekonomisë Kultures dhe Inovacionit në pronësi të Bashkisë Shkodër.

Bashkëlidhur gjeni:

Projekt Vendim 1 (nje) fletë.

Relacion 2 (dy) fletë.

Shkresë e Bashkisë Shkoder nr.4381 prot, datë 20.02.2025 me lëndë "Kërkesë për transferim prone drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit. (1 fletë)

Shkresë e Ministrisë së Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit nr.5796/1. prot datë, 25.04.2025 me lëndë "Dërgohet për mendim projektvendim (5 flete)

Shkresë e Bashkisë Shkoder nr.8635/1 prot, datë 14.05.2025 me lëndë "Kthim përgjigje shkresës me nr.5796/1. prot datë, 25.04.2025 1 fletë

Shkresë nga Ministria e Drejtësisë me lëndë "Kthim përgjigje për një projektvendim (1 fletë)

Duke Ju uruar punë të mbarë!

Me respekt.

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIM

ZV/KRYETAR

Alban PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 14796/11 Prot

Shkodër, më 21.07.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____, _____/2025

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E 89.65% AKSIONEVE TË
“DUHAN CIGARE” SH.A NGA MINISTRIA E EKONOMISË KULTURES DHE
INOVACIONIT NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës, _____, _____/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nën-pika 1.2, të ligjit nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar; ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesite e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Udhëzimit Nr.15, datë 30.06.2003 "Për menyrën e paraqitjes nga njesite e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike, dhe sipas relacionit të paraqitur nga administrata e bashkisë Shkodër,;

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e 89.65% aksioneve të "Duhan Cigare" sh.a nga Ministria e Ekonomisë Kultures dhe Inovacionit në pronësi të Bashkisë Shkodër.
2. Një kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Ministrisë Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit për vijimin e procedurave përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e pronësisë të pasurisë të sipërcituar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

**Z / KRYETAR
Alban PREKA**



Drejtoria Aseteve dhe Kadastres Urbane

Arban GJOKA



Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve

Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Denis LESHJA

Drejtoria Juridike

Brikena LEQEJZA



Konceptoi: A. Gjoka (Specialist)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETVE DHE KADASTRES URBANE**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____/____/2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E 89.65% AKSIONEVE TË
“DUHAN CIGARE” SH.A NGA MINISTRIA E EKONOMISË KULTURES DHE
INOVACIONIT NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër.

Të nderuar Këshilltarë!

Në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale, për të krijuar hapësira komode, rekreative dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve Bashkia Shkodër ka vlerësuar të domosdoshme nevojën për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pronës me të dhëna si më poshtë:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e 89.65% aksioneve të “Duhan Cigare” sh.a nga Ministria e Ekonomisë Kultures dhe Inovacionit në pronësi të Bashkisë Shkodër.

Ky propozim vjen në vijim të bashkëpunimit institucional me Ministrinë Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit e cila ka në pronësi dhe administruar aksionet e Shoqërisë Duhan Cigare Sh.A në masën 89,65 % të aksioneve.

Bashkia Shkodër ka kërkuar transferimin e pasurisë me nr.11/271, vol 41 fq 38 ZK 8592 pasuri në pronësi të Duhan Cigare sh.a.

Ministria ka shprehur dakortësinë për transferimin e kësaj pasurie së bashku me aksionet pasi këto pasuri janë pjesë e kapitalit të shoqërisë.

Ministria po ashtu ka hartuar projekt vendimin përkatës për ta paraqitur në Këshillin e Ministrave për përfundimin e kësaj procedure me transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të aksioneve të Shoqërisë Duhan Cigare sh.a së bashku me pasurisë me nr.11/271, vol 41 fq 38 ZK 8592 me sipërfaqe prej 42.608.6 m2 truall dhe ndërtesë 24.701.6 m2 të çertifikuara pranë ASHK.

Përsa më sipër për vijimin e kësaj procedure nevojitet vendimi nga Këshilli Bashkiak ku shprehet mbi dakortësinë për miratimin e këtij transferimi.

Referuar korrespondencës shkresore mes institucioneve dhe Bashkisë Shkodër sipas shkresave bashkëlidhur relacionit

- Shkresë e Bashkisë Shkodër nr.4381 prot, datë 20.02.2025 me lëndë "Kërkesë për transferim prone drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit.
- Shkresë e Ministrisë së Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit nr.5796/1.prot datë, 25.04.2025 me lëndë “Dërgohet për mendim projektvendim”.

- Shkresë e Bashkisë Shkoder nr.8635/1 prot, datë 14.05.2025 me lëndë "Kthim përgjigje shkresës me nr.5796/1.prot datë,25.04.2025.
- Shkresë nga Ministria e Drejtësisë me lëndë "Kthim përgjigje për një projektvendim.

Vlerësojmë se ky propozim gjen mbështetje ligjore në dispozitat e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "*Per Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar,Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "*Per transferimin e pronave të paluajtshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*" i ndryshuar,VKM Nr.500, datë 14.08.2001 "*Per inventarizimin e pronave te paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore*",i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr.15, datë 30.06.2003 "*Per mënyren e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike*".

Në zbatim të VKM nr.28, datë 27.1.2023 "*Per përcaktimin e procedurave ë hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve*" Kreu II, paraprakisht kërkon Vendimin e Keshillit Bashkiak dhe Ligjshmërinë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër per trajtimin në vijim sipas procedurave të parashikuara me qëllim përfundimin e procedurave mbi transferimin e këtyre pasurive.

Sa me sipër i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë propozimin : *Miratimin e kërkesës për transferimin e 89.65% aksioneve të "Duhan Cigare" sh.a nga Ministria e Ekonomisë Kultures dhe Inovacionit në pronësi të Bashkisë Shkodër.*

Duke ju falenderuar!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

Alban PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETVE DHE KADASTRES URBANE

Nr. 4381 Prot

Shkodër, më 20 / 2 /2025

Lënda: Kërkesë për transferim prone.

MINISTRISË SË EKONOMISË KULTURES DHE INOVACIONIT

Adresa: "Dëshmorët e 4 Shkurtit" Tiranë

Z.Blendi GONXHJA

MINISTËR I EKONOMISË KULTURES DHE INOVACIONIT

I nderuar z.Ministër !

Duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme që i keni dhënë pushtetit lokal, kërkojmë nga ana juaj të merrni në konsideratë kërkesën si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër me qëllim realizimin e detyrave funksionale për të krijuar hapësira sa me komode dhe ambienteve rekreative multifunksionale për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve bën kërkesën pranë institucionit tuaj për transferimin nën administrim të bashkisë Shkodër të pasurive poshtëshënuara:

- Pasuria nr. 11/271, vol 41 fq 38 ZK 8592 ku ndodhet Shoqëria Duhan Cigare sh.a
- Pasuria nr.10/25 ,vol 23, fq 200 ZK 8592 e regjistruar në emer të "Prodhim Mobilje (Prodhim Kabllo) Ish Uzina e Telave Shkodër.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive nga ana juaj!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

Orind BEFLERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 8635/1 Prot

Shkodër, më 14.05.2025

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr.5796/1.Prot, datë 25.04.2025.

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

MINISTRIT

Z.Blendi GONXHJA

Adresa: Rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë.

Në përgjigje të shkresës Suaj nr.5796/1.prot, datë 25.04.2025, me lëndë "Dërgohet për mendim për një projekt vendim", administruar në bashkinë Shkodër me nr.8635.prot hyrës, datë 28.04.2025, ju informojmë si vijon:

- Bashkia Shkodër bazuar në ligjin nr.139/2015 "Pë vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjin nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"; i ndryshuar pas shqyrtimit të materialit **me qëllim përdorimin e pasurive të kësaj shoqërie në dobi të qytetarëve të Shkodrës, shprehim dakordësinë për miratimin e Projekt Vendimit "Për transferimin e pronësisë së 89,65% të aksioneve të shoqërisë "Duhan Cigare", sh.a Shkodër.**

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin ,

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues MEKI

Nr.Prot. 5796/

, Data 25. 4. 2025

Shkurtimi i lëndës Dëgjim mendimi projektvendimi

Për trajtim nga:	☐ N/Kryetar	☐ Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit	☐ Nj.A Ana e Malit
	☐ N/Kryetar	1. Drejtoria e Sportit	☐ Nj.A Bërdicë
	☐ N/Kryetar	2. Drejtoria e Kulturës	☐ Nj.A Dajç
	☐ Kabineti Z.	3. Teatri "Migjeni"	☐ Nj.A Guri i Zi
☐ Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit	☒ Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse <u>2.5.25</u>	☐ Nj.A Postribë	
1. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	1. Drejtoria Juridike	☐ Nj.A Pult	
2. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit	2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore	☐ Nj.A Rrethina	
3. Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme	3. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	☐ Nj.A Shalë	
☒ 4. Drejtoria e Aseteve dhe Kadastrës Urbane	4. Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit ZIN dhe TIK	☐ Nj.A Shosh	
☐ Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik	☐ Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve Sociale dhe Rinisë	☐ Nj.A Velipojë	
1. Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit	1. Drejtoria e Shërbimeve Sociale	☐ Lagje	
2. Drejtoria e Turizmit	2. Drejtoria e Ndihmës Ekonomike	☐ Drejtoria e Komunikimit dhe Promovimit të Territorit	
3. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP	☐ Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar	☐ Këshilli Bashkiak	
☐ Drejtoria e Arsimit	1. Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor	☐ Njësia e Menaxhimit të projekteve strategjike	
	2. Drejtoria e Financës	☐ Policia Bashkiake	
	☐ Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	☐ Emergjencat Civile	
☐ Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	☐ Q.Trajtimit të Studentëve	☐ Njësia e Prokurimit	
☐ Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	☐ Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç	☐ Njësia e Auditit	
☐ Drejtoria e MZSH	☐ Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç		
	☐ Qendra e Zhvillimit		
		☐ Ujësjetës Kanalizime Shkodër Sh.a.	
		☐ IMT	
		☐ Gjendja Civile	
		☐ Administrimi dhe Inspektoriati i Pyjeve	
		☐ Bio Strajca sh.a	

Afati:

Normal (7 ditë)

Prioritet (3 ditë)

Urgjent (brenda ditës)

Pa afat/për dijeni

Tjetër ___ ditë

Data 28. 4. 2025, Nr.Prot. 8635

Shënime të Kryetarit:

Nënshkrimi: Benet Beci

Marrë në dorëzim: 30. 4. 2025

Nënshkrimi _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 5796 / prot.

VENDIME, UDHEZIME, SHKREPESA, KËRKESA
NR. 8635 DATE 28.4.2025 Tiranë, më 25.4.2025
DËRGUAR NGA:
LËNDA:

Lënda: Dërgohet për mendim një projektvendim.

ADRESA E TITULLARIT:

**Z. ULSI MANJA, MINISTËR
MINISTRIA E DREJTËSISË**

**Z. PETRIT MALAJ, MINISTËR
MINISTRIA E FINANCAVE**

**ZNJ. LORENA GOXHOBELLI, DREJTOR I PËRGJITHSHËM
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

**Z. BENET BECI, KRYETAR BASHKIE
BASHKIA SHKODER ✓**

Të nderuar,

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë për mendim projektvendimin “Për transferimin e pronësisë së 89,65% të aksioneve të shoqërisë “DUHAN CIGARE” sh.a., Shkodër, në likuidim, nga Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit te Bashkia Shkodër”, së bashku me relacionin shpjegues.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, Datë _____ 2025

PËR

**PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 89,65% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË
“DUHAN CIGARE” SH.A., SHKODËR, NË LIKUIDIM, NGA MINISTRIA E
EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT TE BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, paragrafit 3 të nenit 4 të ligjit 8744, datë 22.02.2001
“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”,
me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 89.65 % të aksioneve të shoqërisë “ Duhan Cigare” sh.a., Shkodër, në likuidim, nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit te Bashkia Shkodër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.
2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTËR

BLENDI GONXHJA

RELACION PËR

PROJEKTVENDIMIN PËR TRANFERIMIN E PRONËSISË SË 89,65% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË “DUHAN CIGARE” SH.A., SHKODËR, NË LIKUIDIM, NGA MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT TEK BASHKIA SHKODËR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektvendimit është transferimi i 89.65 % të aksioneve të shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a. në likuidim, Shkodër, nga Ministria Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit te Bashkia Shkodër.

Ky transferim ka si qëllim kalimin e të drejtës së përfaqësuesit nga Ministria përgjegjëse për ekonominë te Bashkia Shkodër, gjë e cila do të sjellë menaxhimin më mirë të shoqërisë, duke u nisur nga vendndodhja e shoqërisë.

Kalimi i pronësisë së kësaj shoqërie tek Bashkia Shkodër lidhet edhe me politikat sociale që kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore për këtë pjesë të shoqërisë, me qëllim krijimin e kushteve më komode dhe ambienteve rekreative multifunksionale për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi i mësipërm nuk është parashikuar në programin analitik të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacioni, por është në përputhje të plotë me programin e qeverisë për zhvillimin ekonomik, urban, rural dhe rajonal.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për transferimin e 89.65 % të paketës së aksioneve të shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a. në likuidim, Shkodër nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit tek Bashkia Shkodër.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Bashkia Shkodër me shkresën nr.4381, datë 20.02.2025 drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka kërkuar kalimin e disa pronave nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në pronësi të saj, me qëllim krijimin e hapësirave dhe ambienteve rekreative multifunkionale për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Pasuria me nr.11/271. Vol 41, fq 38, ZK 8592 është në pronësi të shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a. në likuidim, Shkodër, ku Ministria Përgjegjëse për Ekonominë (MEKI) ka 89.65 % të aksioneve.

Meqënëse, pasuria e sipërcituar është pjesë e kapitalit të shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a., në likuidim, nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është marrë iniciativa ligjore për hartimin e këtij projektvendimi, për kalimin e aksioneve në pronësi të Bashkisë Shkodër, me qëllim përdorimin e pasurive të kësaj shoqërie në dobi të qytetarëve të Shkodrës .

Transferimin e pronësisë së 89.65 % të aksioneve të shoqërisë “ Duhan Cigare” sh.a. Shkodër, në likuidim, nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit tek Bashkia Shkodër bëhet me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi i mësipërm është hartuar duke u mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës, paragrafit të tretë të nenit 4 të ligjit 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për transferimin e 89.65 % të paketës së aksioneve të shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a. në likuidim, Shkodër nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit tek Bashkia Shkodër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KODIFIKIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË LEGJSLACIONIT**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2025

Lënda: Kthim përgjigje për një projektvendim

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Tiranë

Për projektvendimin “Për transferimin e pronësisë së 89,65% të aksioneve të shoqërisë “Duhan Cigare” sh.a., Shkodër, në likuidim, nga Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit te Bashkia Shkodër”, dërguar për bashkërendim përmes sistemit elektronik e-aktet, Ministria e Drejtësisë shprehet parimisht dakord, duke sjellë në vëmendje se akti ka karakter individual dhe si i tillë, në përputhje me pikën 2, të nenit 29 të ligjit nr.9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, hyn në fuqi menjëherë, por botohet në Fletoren Zyrtare. Gjithashtu, sugjerojmë që në përputhje me shkronjën “c”, të paragrafit 1.2, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në momentin e përcjelljes së praktikës për miratim pranë Këshillit të Ministrave, t’i bashkëlidhet edhe vendimi i këshillit bashkiak të bashkisë Shkodër, përmes të cilit shprehet pëlqimi/miratimi për marrjen në pronësi të pasurisë së luajtshme objekt projektakti.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

MINISTRI

Ulsi Manja

Ulsi
Manja

Digitally signed by: Ulsi
Manja
Date: 2025.07.07 05:04:56
+02'00'

Ulsi
Manja

Digitally signed by:
Ulsi Manja
Date: 2025.07.07
05:04:56 +02'00'